

MARC LEVY  
**AJO DHE AI**  
ROMAN

---

BOTIMET TOENA



MARC LEVY

# AJO DHE AI

roman

Përktheu nga origjinali frëngjisht  
Adriana Gjika

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2020

Autori: Marc Levy (Mark Levi)  
Titulli në original: Elle et lui  
Botuar në frëngjisht nga: Editions Robert Laffont / Versilio

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo  
Redaktore letrare: Besa Vila  
Korrektore letrare: Majlinda Bami  
Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-81-7

© Marc Levy/Versilio, 2015  
[www.marclevy.info](http://www.marclevy.info)  
© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

**BOTIMET TOENA**  
Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë  
Tel.: + 355 4 22 40 116  
Email: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)  
[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)  
[www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

*Tim ati,  
Fëmijëve të mi,  
Bashkëshortes sime.*



*Ndonjë ditë, do të jetoj në teori,  
sepse në teori gjithçka shkon fjollë...*





## 1.

Shiu kishte shpëlarë çatitë dhe fasadat, veturat dhe autobusët, trotuaret dhe këmbësorët, dhe nuk kishte reshtur së rëni në Londër qysh nga fillimi i pranverës. Mia po dilte nga një takim me agjentin e saj.

Krestoni ishte me të vjetrën, nga ata që thonë gjithmonë të vërtetën, por me finesë.

Duke e shtrirë elegancën e vet deri në ligjërim, ai ishte i respektuar, shpesh i përmendur nëpër darka për vërejtjet e tij therëse, por asnjëherë fyese. Mia ishte nën mbrojtjen e tij, çka, në universin mizor dhe shpesh harbut të kinemasë, vlente sa gjithë privilegjet e botës.

Atë ditë, kishte shkuar të shihte shfaqjen private të filmit të ri të Mias, e meqë ia ndalonte ta shoqëronte në rrethana të tilla, ajo e kishte pritur në zyrën e saj.

Pasi kishte hequr fëshfëshen, Krestoni ishte rehatuar në kolltuk dhe nuk kishte pritur gjatë.

- Aksion, pakëz romantizëm, një skenar i thurur shkathtësisht rreth një intrige që nuk është koherente,

por kush po pyet në ditët e sotme?... Do të jetë një sukses i madh, - e kishte siguruar ai.

Mia e njihte shumë mirë Krestonin dhe e dinte që ai nuk do të kënaqej me kaq.

- Ajo ishte e mrekullueshme, - kishte vazhduar ai, - pak si shumë e zhveshur, duhet të jemi vigjilentë herën tjetër dhe mos të nxjerrim të pasmet në çdo tri skena, - ai do të kishte kujdes për këtë gjë, për të mirën e karrierës së saj, sepse njerëzit kategorizohen shumë shpejt.

- Pohomani sinqerisht, çfarë menduat, Kreston?

- Ti luan në mënyrë të përsosur, dhe roli yt duke qenë ai që është, nuk ishte i thjeshtë. Thënë këtë, nuk mund të xhirojmë pafundësisht filma ku personazhet përshkojnë vjeshtën midis dy tradhtive, tri pabesive bashkëshortore dhe një tasi çaj. Është një film aksion, kamera lëviz shumë, personazhet gjithashtu... çfarë mund të shtoj tjetër?

- Të vërtetën, Kreston!

- Është një m..., e dashur, një m... i madh që do të ketë shumë sukses, meqë yt shoq dhe ti keni dalë në afishe. Në vetvete, është një ngjarje, e vetmja në fund të fundit. Shtypi do të çmendet nga bashkëfajësia juaj në ekran, do të dojë akoma më shumë që ti t'i vjedhësh namin, dhe ky nuk është kompliment, por një gjë që duket sheshit.

- Në përditshmëri, është ai diva, - u përgjigj Mia me një buzëqeshje të zbehtë.

Krestoni fërkoj mjekrën, gjest që, i bërë nga ai, thoshte shumë.

- Si po ia kalon çifti juaj?

- S'po ia kalon fare.

- Kujdes, Mia, jo budallallëqe.

- Çfarë budallallëqesh?

- Më kuptove shkëlqyer. Aq keq po shkojnë punët?

- Xhirimi i filmit nuk na afroi dot.

- Ja, tamam ajo që nuk doja të dëgjoja, të paktën derisa të dalë nëpër sallat e kinemave. E ardhmja e kryeveprës mbështetet në binomin tuaj, në ekran, por dhe në përditshmëri.

- A keni skenarë për mua?

- Kam disa.

- Kreston, do të doja të dilja jashtë shtetit, larg Londrës dhe ngjyrës së saj gri, të luaja një rol të zgjuar, të ndjeshëm, të dëgjoja gjëra që më prekin, që më bëjnë të qesh, të ndaja pak dhembshuri, sikur edhe në një film të vogël fare.

- Edhe unë do të doja që "Xhaguari" im i vjetër të mos prishej asnjëherë, por mekaniku që merret me të, ka krijuar afinitet me mua e më drejtohet me emër, kupton? Kam luftuar për të të ndërtuar një karrierë, ti ke një publik të madh në Angli, adhures që do të paguanin për të të dëgjuar të recitoje një numëror telefonik, ke filluar të pëlqehesh nga pak kudo në kontinent, shpërblimet e tua janë astronomike për kohët që po jetojmë dhe, nëse ky film korr suksesin që parashikoj, ti së shpejti do të jesh aktorja më e

kuotuar e brezit tënd. Kështu që, pak durim, të lutem. Dakord? Për disa javë propozimet amerikane do të rrjedhin si ky shiu tani. Ti do të hysh në oborrin e të mëdhave.

- Të budallaqeve të mëdha që buzëqeshin ndërkohë që janë të trishtuara?

Krestoni u drejtua në kolltuk dhe u kollit.

- Të budallaqeve të mëdha dhe të tjerave që janë të lumtura. Të lutem, nuk dua ta shoh më këtë fytyrë të brengosur, Mia, - shtoi ai duke ngritur tonin. - Intervistat duhet t'ju afrojnë, ty dhe tët shoq. Duhet të buzëqeshni aq shumë gjatë promovimit saqë në fund do t'ju pëlqejë dhe juve vetë.

Mia bëri një hap drejt bibliotekës, hapi një kuti cigaresh që ndodhej mbi një raft dhe mori një.

- E di ti që unë urrej të tymosin në zyrën time?

- Atëherë, përse e mbani këtë kuti?

- Për rastet urgjente.

Mia fiksoi me sy Krestonin dhe u ul, me cigaren të pandezur në buzë.

- Mendoj se ai ma dredh.

- Në një mënyrë a në një tjetër, kujt nuk ia dredhin sot? - u përgjigj ai duke parë korrespondencën.

- Por nuk është e këndshme.

Krestoni la leximin.

- Si ta dredh? - tha ai. - Dua të them me raste, apo gjithë kohës?

- E çfarë ndryshon kjo?

- Po ti, asnjëherë nuk e ke tradhtuar?...

- Jo. Në fakt, një herë, një puthje. Partneri im puthte mirë dhe kisha nevojë të më puthnin. Ishte për vërtetësinë e skenës, nuk është tamam tradhti, apo jo?

- Është qëllimi ai që ka rëndësi. Në cilin film? - pyeti Krestoni duke ngritur njëren vetull.

Mia pa nga dritarja dhe agjenti i saj psherëtiu.

- Mirë, le të pranojmë që ai ta dredh. Çfarë rëndësie ka kjo përderisa ju nuk duheni më?

- Është ai që s'më do mua, unë e dua.

Krestoni hapi sirtarin, nxori një taketuke dhe ndezi një shkrepëse. Mia thithi një duhmë të gjatë e ai vriste mendjen nëse ishte tymi që po i digjte sytë, por nuk ia bëri asaj pyetjen.

- Ai ishte diva dhe ti, një fillestare. Ai luajti Pigmalionin dhe nxënësja ia kaloi mësuesit. Nuk duhet të jetë e lehtë në jetën e përditshme për egon e tij. Kujdes me hirin, e dua shumë këtë tapet.

- Mos e thoni këtë, nuk është e vërtetë.

- Sigurisht që po. Nuk them se është aktor i keq, por...

- Por çfarë?

- Nuk është momenti, do të flasim më vonë, kam të tjera takime tani.

Krestoni bëri një xhiro nëpër zyrë, hoqi me delikatesë cigaren nga duart e Mias dhe e shtypi në taketuke. E kapi nga supet dhe e tërhoqi drejt derës.

- Së shpejti, do të luash ku të duash ti, në Nju-Jork, në Los Anxhelos, në Romë. Deri atëherë, mos bëj

budallallëqe. Një muaj, vetëm kaq po të kërkoj, prej saj varet e ardhmja jote. Më premtan?

\*

Pasi doli nga Krestoni, Mia arriti në “Oksford Strit” me taksi. Kur ishte e mërztur, dhe kjo i kishte ndodhur disa herë këto javët e fundit, shkante të shëtiste në këtë arterie tregtare plot lëvizje.

Duke përshkuar rrugicat e një dyqani të madh, ishte përpkur të lidhej me Davidin, por i kishte dalë direkt sekretaria telefonike.

Me çfarë merret ai në këtë fund pasditeje? Ku ishte prej dy ditësh? Dy ditë e dy net pa asnjë lajm tjetër përveç një mesazhi të lënë në sekretarinë telefonike të apartamentit të tyre. Një mesazh lakonik që shpjegonte se ai po shkante të karikohej në fshat, dhe se ajo nuk duhej të shqetësohej. Ajo bënte krejt të kundërtën.

Kur u kthye në shtëpi, Mia kishte vendosur të mblidhte veten. Kur të kthehej Davidi, as që bëhej fjalë që ajo të tregonte pështjellim. Të mbetej e denjë, e zonja e vetes, të mos i lejonte të mendonte për asnjë çast se ishte mërztur shumë nga mungesa e tij, dhe sidomos të mos i bënte asnjë pyetje.

Duke iu përgjigjur thirrjes së një shoqeje, e cila e kishte lutur ta shoqëronte në përrurimin e një restoranti, Mia kishte vendosur të bëhej e bukur. Edhe ajo ishte e aftë ta bënte xheloz Davidin. E tekefundit, më mirë

të ishte e rrethuar me të panjohur sesa të bluante mendime të hidhura në shtëpi.

Restoranti ishte i stërmadh, muzika tepër e fortë, salla e mbipopulluar, e pamundur të flisje me ndonjë apo të bëje një hap pa u fërkuar me të tjerët. *Kush mund të kënaqej në një mbrëmje të tillë?* - mendoi duke u përgatitur për t'i bërë ballë kësaj batice njerëzore.

Aparatet fotografike u shkrepën që në hyrje. Ja përse shoqja e donte shoqërinë e saj. Shpresonte të dilte në faqet *People* të ndonjë reviste. Sensacioni i famës jetëshkurtër. *E marrtë dreqi, David, përse më lë të vërdallisem e vetme në vende të tilla? Do ta paguash njëqindfish "Zoti Kam-nevojë-të-karikohem"*.

Ra zilja e telefonit, një thirrje e maskuar, në këtë orë, patjetër që është ai. Si mund ta dëgjosh në gjithë këtë rrëmujë. *Po të isha snajper, do ta kisha vrarë DJ-in*, mendoi ajo.

Përfshiu horizontin me vështrim, ishte në gjysmë të rrugës midis hyrjes dhe kuzhinës. Turma po e shtynte drejt kuzhinës, por ajo vendosi të ecte në të kundërt të rrymës. Hapi telefonin dhe ulëriti:

- Mos e mbyll! *Mirë si fillim për dikë që është betuar të mos kuptohet, e dashur.*

Çaje rrugën, shtyje tangërlliksen mbi takat e larta dhe atë gdhenë që po i vjen rrotull. Shtypja shputat skërhelles së gjatë skeletike që po përdridhet si ngjalë, shmange pispilluqin që po e vështron si pré,

*do të kënaqesh, plako, ajo duket sikur ka muhabet.*  
Vetëm dhjetë hapa deri te porta.

- Qëndro në linjë, David! *Po pusho, moj idiote.*

Lutju me vështrim rojës që të të ndihmojë të dalësh prej aty.

Më në fund jashtë, ajri i freskët, qetësia relative e rrugës. Largohu nga njerëzit që janë ngjeshur duke pritur të futen në këtë ferr.

- David?

- Ku je?

- Në një mbrëmje... *Si e paska guximin e bën një pyetje të tillë?*

- Po argëtohesh, e dashur?

- *Hipokrit!* Po, është mjaft e këndshme... *Ku shkove dhe e gjete një gjë të tillë!* Po ti, *more gdhe*, ku je... *prej dy ditësh?*

- Rrugës për në shtëpi. Do të kthehesh shpejt?

- Jam në taksi... *Gjeje një taksi, shpejt një taksi.*

- Kujtova se ishe në ndonjë mbrëmje.

- Prej andej po dilja kur më thirre ti.

- Me sa duket do të mbërrish para meje, po të jesh e lodhur, mos më prit, ka shumë trafik, edhe në këtë orë. Londra është bërë me të vërtetë e padurueshme!

*Je ti që je bërë i padurueshëm, si guxon të më thuash mos të të pres? U bënë dy ditë që vetëm këtë gjë bëj, po të pres ty.*

- Do të lë ndezur dritën e dhomës.

- Mrekulli, të puth, mirupafshim!



Një trotuar i ndriçuar, ca çifte nën çadra...  
*... e unë, vetëm, si një debile. Nesër, me filmin apo  
pa filmin, do të ndryshoj jetë. Jo, jo nesër, sonte!*

## 2.

Paris, të pasnesërmen.

- Përse ndodh gjithmonë që është çelësi i fundit ai që hap derën? - protestoi Mia.

- Sepse jeta është bërë për së prapthi, pa këto shkallët nuk do të ishin të zhytura në terr, - u përgjigj Dejzi duke ndriçuar bravën me celular sa më mirë që mundte.

- Nuk dua më të pëlqej idenë e dikujt, dua një realitet që të më korrespondojë; dua të tashme, vetëm të tashme.

- Dhe unë një të ardhme më pak të pasigurt, - psherëtiu Dejzi. - Ndërkohë, nëse s'po e hap dot, m'i jep mua çelësat se nuk kam pothuaj më bateri.

Në fakt, ishte çelësi i fundit i tufës ai që hapi derën. Duke hyrë në apartament, Dejzi shtypi çelësin, pa rezultat.

- Duket se gjithë pallati s'paska drita.

- Edhe jeta ime, - shtoi Mia.

- Mos ta teprojmë tani!

- Nuk di të jetoj me gënjeshtër, - vazhdoi Mia me një ton që kërkonte dhembshuri, por Dejzi e njihte prej shumë kohësh e nuk hynte në këtë lojë të vogël.

- Mos fol kot, ti je një aktore e talentuar, pra një gënjeshtër profesioniste... Duhet të kem ca qirinj diku, duhet t'i gjeja po qe se bateria e *iPhonit*...

Ekрани i telefonit u shua.

- Po sikur t'u thosha të gjithëve të pirdhen? - pëshpëriti Mia.

- Nuk të bie ndër mend të më ndihmosh pak?

- Po, por me të vërtetë nuk shihet asgjë.

- Jam e qetë që po ndërgjegjësohesh!

Dejzi eci verbazi. Dora i preku tavolinën. Duke i dalë nga krahët, u përplas me një karrige, u grind, dhe arriti te tavolina e punës, fill mbrapa. Gjithmonë verbazi, iu afrua sobës, kapi shkrepëset e lëna mbi raft, rrotulloi butonin e njërës vatër dhe ndezi gazin.

Një aureolë blu ndriçoi vendin ku ndodhej.

Mia u ul në tavolinë.

Dejzi rrëmoi sirtarët një e nga një. Qirinjtë aromatike nuk kishin të drejtën e banimit në shtëpinë e saj. Pasioni për gastronominë kishte kërkesat e veta, asgjë nuk duhet të prishte erën e një gjelle. Atje ku disa afishonin mbi derën e restorantit "*Restoranti nuk pranon karta krediti*", kjo do të kishte shkruar me shumë dëshirë "*Restoranti im nuk pranon hyrjen e personave tepër të parfumuar*".

Gjeti qirinjtë dhe i ndezi. Ndriçimi i projektuar nga flakët e nxori dhomën nga errësira.

Apartamenti i Dejzit përmbliedhej, po të themi kështu, në vetëm kuzhinën e saj. Kjo ishte dhoma që jetohej, më e madhe se dy dhomat e vogla ngjitur të ndara nga një banjë. Në tavolinën e punës ndodheshin kupa balte të pjekura, ngjeshur njëra pas tjetrës, filiza trumze, dafine, rozmarine, kopre, rigoni, buzoreje dhe spec të kuq. Kjo kuzhinë ishte laborator i Dejzit, dehja dhe ilaçi i saj. Atje përpunonte recetat para se klientela e restorantit të saj, që ndodhej në kodërzën Montmartre dy hapa larg shtëpisë, të përfitonte prej tyre.

Dejzi nuk kishte bërë studime në universitet, zanatin e kishte nga klani i saj dhe nga vendlindja, Provansa. Kur ishte fëmijë, ndërkohë që shokët luanin nën hijen e pishave dhe të ullinjve, ajo vëzhgonte t'ëmën dhe mësonte të riprodhonte të njëjtat gjëra.

Në kopshtin që rrethonte shtëpinë e tyre, kishte mësuar të seleksiononte barërat dhe pas furrës kishte mësuar t'i sistemonte. Gatimi ishte jeta e saj.

- Ke uri? - e pyeti ajo Mian.

- Po, ndoshta. Në fakt, nuk e di.

Dejzi nxori nga frigoriferi një pjatë me kërpudha, një tufë majdanozi dhe shkuli një hudhër nga vargu që varej në të djathtë të saj.

- Hudhra është e domosdoshme? - pyeti Mia.

- Mos ke ndër mend të puthësh ndonjë sonte? - ia ktheu Dejzi duke e prerë hudhrën me thikë. - Ndërsa unë gatuaj, ti do të më tregosh ç'ndodhi.

Mia mori frymë thellë.

- Asgjë nuk ndodhi.

- Ti mbin kur unë mbyll restorantin me një çantë udhëtimi në dorë, me çehren e dikujt të cilit i është përmbysur bota; nuk reshte së ankuari qysh atëherë. Prej kësaj nxjerr si konkluzion se nuk erdhe të më vizitosh ngaqë të kishte marrë malli për mua.

- Bota ime me të vërtetë është shembur.

Dejzi e ndërpreu atë që po përgatiste.

- Të lutem, Mia! Jam gati të dëgjoj gjithçka, veç jo me psherëtima e me ankime, nuk ka kamera këtu.

- Ti do të ishe bërë një regjisore e shkëlqyer! - tha Mia.

- Ndoshta. Po të dëgjoj.

E ndërkohë që Dejzi po merrej me punë në kuzhinë, Mia qëndronte në tavolinë.

\*

Në momentin kur erdhën dritat, të dy mikeshat u hodhën nga gëzimi. Dejzi shtypi butonin për të zbutur ndriçimin, pastaj hapi grilat, duke zbuluar pamjen që ofrohej mbi Paris nga apartamenti i saj.

Mia shkoi drejt dritares.

- Ke cigare?

- Në tavolinën e mesit, nuk e di kush i ka harruar atje.

- Me sa duket ke shumë të dashur dhe nuk e di cili mund t'i ketë harruar cigaret në shtëpinë tënde?

- Në do të tymosësh, shko në tarracë!
- Do të vish me mua?
- A kam zgjedhje tjetër nëse dua të di vazhdimin?

\*

- Dhe ti e lë dritën ndezur në dhomë? - pyeti Dejzi duke rishërbyer verën.

- Po, por jo në dhomën-gardërobë. Atje, lashë një stol që ai të përplasej.

- Paskeni dhomë-gardërobë? - pyeti Dejzi. - Po pastaj?

- Bëra kinse sikur po flija. Ai u zhvesh në banjë, e pastaj erdhi të shtrihej dhe fiku dritën. Prita të më murmuriste ca fjalë e të më përqafonte. Si duket nuk ishte karikuar mjaftueshëm dhe e zuri gjumi.

- Mirë, a e do mendimin tim? Gjithsesi po ta them. Ti je martuar me një ndyrësirë. Pyetja e vërtetë, dhe ajo është shumë e thjeshtë, është të dish nëse cilësitë e tij i bëjnë defektet të dashura për ty. Jo, pyetja e vërtetë është të dish përse je e dashuruar pas tij, ndërkohë që ai të bën kaq të palumtur. Vetëm po të jesh e dashuruar pas tij pikërisht ngaqë të bën të palumtur.

- Më bëri shumë të lumtur, në fillim.

- Shpresoj! Nëse fillimet do të ishin të shpifura, princërit e kaltër do të zhdukeshin nga letërsia dhe komeditë romantike do të klasifikoheshin te filmat horror. Mos më këqyr ashtu, Mia. Po do të dish nëse të mashtron, duhet t'ia bësh atij këtë pyetje, jo mua.

Dhe lëre atë cigare, po tymos shumë, është duhan, nuk është dashuri.

Mbi faqet e Mias rrodhën lot.

Dejzi shkoi e u ul pranë saj për ta mbështjellë me krahë.

- Qaje dehjen tënde, qaj nëse kjo të lehtëson. Brengat e dashurisë të dhembin si dreqi, por fatkeqësia më e madhe është kur jeta është një shkretëtirë.

Mia ishte betuar të mbetj e denjë në çdo rrethanë, por pranë Dejzit, ishte ndryshe. Një miqësi si e tyrja, që zgjat prej shumë kohësh, është miqësi që e zgjedhim vetë.

- Përse flet për shkretëtirë? - e mori ajo fjalën duke fshirë faqet.

- Është mënyra jote për të më pyetur më në fund si po më venë punët?

- Edhe ti ndihesh vetëm? Beson se një ditë do të jemi të lumtura?

- Kam përshtypjen se ti nuk ke qenë pak herë e tillë gjatë këtyre viteve të fundit. Je një aktore e njohur dhe e stërnjohur, fiton nga një film atë që mua do të më duhej një jetë të tërë për ta fituar, e për më tepër... je e martuar. E pe gazetën e mbrëmjes... nuk ke të drejtë të qahesh.

- Pse, çfarë ka ngjarë?

- S'e kam idenë, por po të kishte ndonjë lajm të mirë, njerëzit do të ishin nëpër rrugë për të festuar ngjarjen. Si ishin kërpudhat?

- Gatimi yt është antidepresanti më i mirë në botë.

- Si kujton ti, pse doja të bëhesha shefe kuzhine unë? Tani, në shtrat! Nesër do t'i telefonoj atij burrit tënd idiot, do t'i them që ti i ke marrë vesh të gjitha, që ai ka tradhtuar gruan më gjeniale të mundshme, që ti do ta lësh, jo për ndonjë tjetër, por për shkak të tij. E kur unë ta kem mbyllur, do të jetë ai fatkeqi.

- Nuk do ta bësh?

- Jo, në fakt, je ti që do ta bësh.

- Edhe pse kam shumë dëshirë, nuk mundem.

- Pse? Do të ngushëllohesh në ndonjë melodramë koti?

- Sepse ne jemi të dy në një afishe filmi me buxhet mjaft të madh, që do të dalë për një muaj. Jam e detyruar të luaj gjithashtu komedinë në përditshmëri, rolin e mrekullueshëm të gruas së plotësuar, lumturia e përkryer. Po të marrin vesh të vërtetën për Davidin dhe për mua, kush do t'i besonte çiftit tonë në film? Producentët nuk do të ma falnin, agjenti im gjithashtu. Pastaj, më pëlqen të jem një brinare e vetëdijshme, por jo e poshtëruar në publik.

- Gjithsesi, duhet të jesh një drej kuçke për t'ia dalë mbanë një roli të tillë.

- Po përse mendon se erdha këtu, nuk do të jem kurrë e aftë ta luaj këtë rol kaq gjatë. Duhet të më mbash në shtëpinë tënde.

- Sa kohë?

- Aq sa të më durosh.



### 3.

Sapo mbërriti te porta “Shapel”, kabrioleja “Sab” kaloi tri korsi diagonal, duke mos ua varur sinjaleve me drita të drejtuesve të mjeteve, dhe la unazën për të hyrë në autostradën A1 me drejtim për në “Ruasi-Sharl-dë-Gol”.

“Përse jam gjithmonë unë që e pres në aeroport? Tridhjetë vjet miqësi dhe betohem që ai s’ma ka kthyer asnjëherë me të njëjtën monedhë. Jam shumë i sjellshëm, ja, ky është problemi! Pa mua, ata as që do të ishin bashkë sot. Një falënderim i vogël, nuk do ta varfëronte, po jo, asgjë!” - Kështu murmuriste Poli duke u parë në pasqyrën që sheh prapa. “Mirë, dakord, unë jam kumbari i Xhosë, po kë tjetër mund të zgjidhnin ata? Pilgezin? Gjallë në botë! E pastaj gruaja e tij është tashmë kumbare. Mirë e them, unë gjithmonë u shërbej njerëzve, më iku jeta duke u shërbyer të tjerëve. Nuk them se nuk më kënaq kjo, por do të më pëlqente gjithashtu që dhe të tjerët

të merreshin pak me mua. Lorena, për shembull, kur unë jetoja në San-Francisko, a do të më kishte prezantuar me ndonjë studente të brendshme që punonte në spital? Këto nuk mungojnë në spitalin e saj, zaten as të jashtmet nuk mungojnë. E po ja që jo, kurrë! Duke qenë kështu, ato kanë dhe orare shumë të vështira. Nëse ky tipi pas meje më jep prapë sinjal me drita, do ta shqep në dru! Duhet të mos flas me vete, Arturi kishte të drejtë, do të më marrin për të çmendur. Në të njëjtën kohë, me cilin të flasësh? Me personazhet e librave të mi? Jo, duhet të pushoj, se ngjaj si plak pastaj. Pleqtë flasin me vete. Në fakt, kur janë vetëm, ose përndryshe flasin me njëri-tjetrin ose u flasin fëmijëve të tyre. A do të kem fëmijë ndonjë ditë? Edhe unë do të plakem”.

U pa sërish në pasqyrën që sheh prapa. “Sabi” ndaloj përpara traut automatik, Poli mori biletën.

- Faleminderit, - tha teksa mbylli xhamin.

Avioni “AF 83” ishte shfaqur në orar në ekranin e madh të mbërritjeve. Poli përplaste këmbët nga padurimi.

Udhëtarët e parë filluan të dilnin, vetëm një turmë e vogël, me sa duket biznes klasi.

\*

Pasi kishte botuar romanin e parë, Poli kishte vendosur ta linte në kllapa karrierën e tij si arkitekt.

Të shkruarit i kishte ofruar një liri të padyshimtë. Asgjë nuk kishte qenë e paramenduar. Thjesht kishte ndier kënaqësi teksa nxinte faqe të tëra, afro treqind të tilla kur kishte shtypur fjalën “Fund”. Çdo mbrëmje, ndihej i përfshirë në tregim, pothuaj nuk dilte fare dhe më së shpeshti darkonte para kompjuterit.

Natën, Poli hynte në një botë imagjinare ku ndihej i lumtur nën shoqërinë e personazheve të bëra tashmë miq. Nën penën e tij, gjithçka bëhej e mundur.

Sapo teksti kishte mbaruar, ai e linte mbi tavolinë.

Jeta e tij ishte përmbysur disa javë më pas, gjatë një vakti ku Arturi dhe Lorena ishin ftuar në shtëpinë e tij. Gjatë mbrëmjes, Lorena kishte marrë një telefonatë nga një administrator spitali. Ajo i kishte kërkuar Polit të mbyllej në zyrën e tij, duke i lënë ata, Arturin dhe Polin, të bënin muhabet në sallon.

E bezdisur nga fjalët e bashkëbiseduesit, Lorena kishte dalluar dorëshkrimin dhe kishte filluar t’i kthente faqet, e mbërthyer deri në atë pikë sa që kishte humbur fillin e bisedës.

Kur më në fund profesor Krausi e kishte mbyllur telefonatën, Lorena kishte vazhduar leximin. Kishte kaluar një orë kur Poli futi kokën në zyrën e tij me qëllim që të verifikonte nëse gjithçka po shkonte mirë dhe e kapi gjallë, me një buzëqeshje në fytyrë.

- Të bezdis? - kishte thënë ai, duke e drithëruar atë.

- Qenka e mrekullueshme, e di?

- Nuk mendon se duhet të më kishe kërkuar leje më parë?

- A mund ta marr që ta mbaroj?
- Njerëzit normalë nuk u përgjigjen pyetjeve me një pyetje tjetër!
- E megjithatë, ti këtë gjë po bën. A mundem?
- Të pëlqen vërtet? - kishte vijuar Poli, dyshues.
- Po, me të vërtetë, - ia kishte kthyer Lorena duke grumbulluar fletët.

Pastaj ajo e kishte marrë dorëshkrimin dhe ishte kthyer në sallon, duke kaluar para Polit pa shtuar asnjë fjalë.

- Më dëgjove gjë të të thosha po? - kishte vazhduar ai duke iu afruar.

Dhe i kishte pëshpëritur në vesh që të mos fliste për të me Arturin.

- Po, për çfarë? - ishte shqetësuar ky i fundit duke u ngritur.

- Nuk e di, - i ishte përgjigjur Lorena. - Do të ikim?

Dhe para se Poli të gjente kohën për të reaguuar, Arturi dhe Lorena, tashmë te peroni i shkallëve, e kishin falënderuar për mbrëmjen.

\*

Udhëtarë të tjerë po dilnin, me shumicë kësaj here. Nja tridhjetë, por gjithmonë jo ata për të cilët ai kishte ardhur.

“Çfarë po bëjnë këta? Po pastrojnë avionin? Për çfarë më ka marrë malli realisht që kur kam ardhur

në Paris? Për shtëpinë në Karmel... Sa më pëlqente të shkoja fundjavave atje, të isha nën shoqërinë e tyre, të zbrisja e të asistojta në perëndimin e diellit në plazh. Së shpejti bëhen shtatë vjet. Ku janë zhdukur ata këto vite? Më shumë malli më ka marrë për ata. Thirrjet në video, janë më mirë se asgjë, por ta marrësh dikë në krahë, të ndiesh praninë e tij, është tjetër gjë. Shiko, duhet të flas me Lorenën për dhimbjet e kokës që më përsëriten shpesh, kjo është fusha e saj. Jo, ajo do të më japë të bëj analiza, është thjesht migrenë, është qesharake, nuk kanë tumor në tru të gjithë njerëzit të cilëve u dhemb koka. Tekefundit, do të shikoj ç’do të bëj. E mirë pra, po këta kur do të dalin?”

\*

“Grin Striti” ishte i shkretë. Pasi e kishte parkuar “Fordin” në parking, Arturi kishte hapur derën e Lorenës dhe kishin ngjitur ca shkallë deri në katin e fundit të shtëpisë viktoriane ku jetonin. Të rrallë ishin çiftet që jetonin në të njëjtin apartament para se të takoheshin, por kjo, është një histori tjetër...

Arturi duhet të përfundonte ca skica për një klient të rëndësishëm. I kërkoi ndjesë Lorenës dhe e puthi para se të rehatohej në tavolinën e tij të arkitektit. Lorena nuk vonoi të rrëshqiste nën çarçafë e të zhytej në dorëshkrimin e Polit.

Shumë herë, Arturit iu duk sikur dëgjonte të qeshura nga ana tjetër e ndarjes. Çdo herë, ai shihte

orën dhe rimerrte lapsin. Më vonë, natën, duke kapur ca si dënese, u ngrit, hapi ngadalë derën e dhomës dhe zbuloi të shoqen, të ulur në shtrat, në kulmin e leximit.

- Çfarë ke? - pyeti ai i shqetësuar.
- Asgjë, - iu përgjigj ajo duke mbyllur dorëshkrimin. Ajo mori një shami letre mbi komodinë dhe u ngrit.
- A mund ta di kush të trishtoi?
- Nuk jam e trishtuar.
- Ndonjë nga pacientët e tu nuk është mirë?
- Jo, është shkëlqyer.
- E kjo të bën të qash?
- Do të vish të shtrihesh?
- Jo para se të më shpjegosh përse nuk po fle.
- Nuk e di, nëse kam të drejtë ta them këtë.

Arturi u ngul para Lorenës, i vendosur t'i nxirrte me zor pohimet.

- Poli, - u dorëzua ajo.
- Është i sëmurë?
- Jo, ka shkruar...
- Çfarë ka shkruar?
- Duhet t'i marr leje para se të...
- Poli dhe unë nuk kemi asnjë sekret për njëritjetrin.
- Me sa duket, po. Mos këmbëngul, eja, është vonë.

Të nesërmen në mbrëmje, Poli mori një telefonatë nga Lorena në agjenci.

- Kam për të të thënë diçka, e mbaroj shërbimin për gjysmë ore, më gjen te kafeneja përballë spitalit.

Në mëdyshje, Poli veshi xhakëtën dhe doli nga zyra. U këmbye me Arturin para ashensorit.

- Ku po shkon?

- Të marr gruan te puna.

- A mund të të shoqëroj?

- Mos je gjë sëmurë, Pol?

- Do të ta shpjegoj gjatë rrugës, shpejto, sa i ngadaltë je!

Kur Lorena u shfaq në parkingun e spitalit, Poli shpejtoi ta takonte dhe e ndali. Arturi po i vëzhgonte një çast para se të vendoste t'u bashkëngjitej.

- Do të takohemi në shtëpi, - i tha ajo. - Poli dhe unë kemi për të diskutuar diçka.

Ata e lanë Arturin në vend dhe hynë në kafene.

- E mbarove së lexuari? - pyeti Poli pasi kishte përzënë kamerieren.

- Po, mbrëmë.

- Të pëlqeu?

- Shumë. Gjeta shumë gjëra që lidheshin me mua.

- E di, ndoshta do të më duhej të kërkoja pëlqimin tënd.

- Mund ta bësh.

- Gjithsesi, askush tjetër përveç teje nuk do ta lexojë këtë histori.

- Pikërisht për këtë doja të diskutoja me ty. Duhet t'ia dërgosh ndonjë botuesi, do të të botohet, jam e sigurt.

Poli nuk donte të dëgjonte të flitej për të. Fillimisht nuk e imagjinonte as një çast të vetëm se dorëshkrimi mund të tërhiqte vëmendjen e ndonjë shtëpie botuese dhe, edhe sikur, ai nuk mund të pranonte idenë që një i huaj të mund të lexonte çka kishte shkruar ai.

Lorena përdori të gjitha argumentet e mundshme, por Poli u kap fort pas të tijave. Duke u larguar, Lorena i kërkoi leje ta ndante sekretin me Arturin, dhe Poli bëri sikur nuk kishte dëgjuar gjë.

Kur u kthye në shtëpi, ajo ia besoi dorëshkrimin Arturit.

- Merre, - i tha, - do të diskutojmë kur ta kesh lexuar të gjithin.

Ishte radha e Lorenës të dëgjonte Arturin që qeshte disa herë, duke ruajtur në qetësi emocionin që e pushtonte gjatë leximit të disa paragrafëve. Ai u kthye tek ajo në sallon pas tri orësh.

- Si t'u duk?

- Shumë i frymëzuar nga historia jonë, por më pëlqeu.

- E këshillova ta dërgojë te ndonjë botues, por ai nuk dëgjon nga ai vesh.

- Unë e kuptoj përse.

Botimi i tregimit të Polit u bë një obsesion për doktoreshën e re. Sapo këmbehej apo diskutonte me të në telefon, i bënte të njëjtën pyetje. A e kishte



dërguar dorëshkrimin? Çdo herë, Poli i përgjigjej në formën negative, duke iu lutur të mos ngulmonte më.

Një të diel, nga fundi i pasdites, ra celulari i Polit. Nuk ishte Lorena, por një botues, “Simon & Schuster”.

- Shumë gallatë, Artur, - kishte thënë Poli me një zë të acaruar.

I habitur, bashkëbiseduesi ia ktheu se ai sapo kishte përfunduar leximin e një romani që i kishte pëlqyer shumë dhe që dëshironte të takonte autorin.

Keqkuptimi zgjati, Poli po shijonte gallatat. Fillimisht i argëtuar, pastaj i mërziur, botuesi i sugjeroi t’i bënte një vizitë qysh të nesërmen në zyrë, do të kishte në këtë mënyrë provën që nuk bëhej fjalë për gallatë.

Në mendjen e Polit zuri vend dyshimi.

- Si e gjetët dorëshkrimin tim?

- Ma dha një miku juaj.

Dhe pasi i komunikoi vendtakimin, tipi mbylli telefonin. Poli bëri ca ecejake nëpër apartamentin e tij. Ngaqë s’po e mbante më vendi, i hipi “Sabit” dhe përshkoi qytetin deri te “San Francisco Memorial Hospitëll”.

Tek urgjenca, kërkoi të takohej menjëherë me Lorenën. Infermierja vërejti se nuk ishte i sëmurë. Poli i hodhi një vështrim tërë inat, urgjencat nuk janë gjithmonë shëndetësore në jetë. I dha dy sekonda që

ta thërriste në *biper* para se të provokonte ndonjë skandal. Infermierja i bëri një shenjë rojës së sigurisë. Më e keqja u shmang kur, sapo pa Polin, Lorena erdhi ta takonte.

- Ç'drejtin bën këtu ti?

- Ke ndonjë mik botues ti?

- Jo, - ia ktheu ajo duke ngulur vështrimin te maja e këpucëve.

- Po Arturi, mos ka ndonjë mik botues?

- As ai, - murmuriti ajo.

- Ndonjë nga shakatë tuaja?

- Kësaj here jo.

- Çfarë bërë?

- Asgjë të keqe, vendimi gjithmonë të përket ty.

- A do të ma shpjegosh?

- Një nga kolegët e mi ka një mik botues, unë ia besova dorëshkrimin për të marrë një mendim asnjanes.

- Nuk kishe të drejtë ta bëje këtë.

- Herë të tjera, edhe ti ke vepruar pa marrë leje nga unë, dhe e sheh, sot të jam mirënjohëse. Provokova pak fatin, e çfarë pastaj? Po ta përsëris, të përket ty vendimi.

- Çfarë vendimi?

- Që ta ndash me të tjerët atë që ke shkruar. Ti nuk je Heminguej, por historia jote mund të sjellë pak lumturi te njerëzit që do ta lexojnë. Siç kanë ardhur kohët, nuk është keq. Tani kam punë.

Ajo u kthye para se të kalonte dyert e urgjencës.

- Në asnjë mënyrë, mos më falëndero.

- Të të falënderoj për çfarë?

- Shko në atë takim, Pol, mos u bëj kokëfortë. Në fakt, nuk i kam thënë ende gjë Arturit.

Poli shkoi të takonte atë botuesin që e kishte vlerësuar romanin dhe iu dorëzua propozimeve të tij. Sa herë që e dëgjonte të shqiptonte fjalën “roman”, e kishte shumë vështirë të vendoste lidhjen me historinë që i kishte mbushur netët në një periudhë kur jeta e tij nuk kishte qenë shumë e lumtur.

Romani u botua gjashtë muaj më vonë. Të nesërmen e daljes nëpër librari, Poli u gjend në ashensorin e punës në shoqërinë e dy kolegëve arkitektë, që kishin librin e tij në dorë. Ata e uruan dhe Poli, si i ngrirë, priti që ata të dilnin dhe shtypi butonin e katit të parë. U nis të ulej në kafenenë ku hante mëngjesin çdo ditë. Kamerierja deshi që ai t’ia firmoste ekzemplarën që kishte blerë. Dora e Polit u drodh teksa shkroi dedikimin. Pagoi faturën, u kthye në shtëpi dhe nisi të rilexonte romanin. Pas çdo faqeje që kthente, zhytej pak më thellë në kolltuk, duke uruar që të shkrihej atje për të mos dalë më kurrë prej andej. Kishte dhënë në atë tregim një pjesë të vetes, të fëmijërisë, të ëndrrave, të shpresave, të dështimeve të tij. Pa e kuptuar, pa e ditur se një ditë do të lexohej nga të panjohur. Akoma më e tmerrshme, njerëz që ishin krah tij, me të cilët ai punonte. Poli babaxhani, shpërthimet e zërit të të cilit

maskonin një modesti të sëmure, mbeti i habitur dhe me krahët e lëshuar, duke pasur vetëm një dëshirë: të bëhej si personazhi i tij, i padukshëm.

I shkrepri në mendje ideja që të blinte gjithë ekzemplarët që ishin në qarkullim. U turr mbi telefon, por para se të mund t'i fliste botuesit për këtë projekt, ky i fundit e përgëzoi për artikullin e po atij mëngjesi në "San Francisco Kronikëll". Sigurisht, kritika po e gërricte nga pak, jo me të pabesë, megjithatë në tërësi artikulli i bënte një reklamë të mirë. Poli ia mbylli menjëherë dhe u sul te kioska e parë e gazetave. Artikulli nënvizonte gabimet e një romani të parë, dhe, më e keqja për Polin, e përgëzonte autorin që nuk kishte pasur frikë nga akuza për ndjeshmëri të tepruar. Në një kohë kur cinizmi kishte më shumë rëndësi sesa inteligjenca, ndoshta duhej parë këtu një akt shumë i guximshëm rezistence, kishte përfunduar gazeta. Poli sikur vdiq. Jo nga një vdekje e menjëhershme, çka sinqerisht do ta kishte lehtësuar, por nga një agoni mbytëse e ngadaltë.

Celulari s'pushonte së rëni, ca numra të panjohur dukeshin në ekran, çdo herë, ai s'përgjigjej. Arriti të hiqte dhe baterinë dhe u zhduk nga ekranet radare. Nuk shkoi në koktejin e organizuar nga botuesi i tij, nuk shkeli në zyrë gjithë javës, ndenji në shtëpi. Një mbrëmje, shpërndarësi i picave i dha një ekzemplar për autograf, duke shtuar se e kishte njohur foton e tij te lajmet e së djeshmes. Pas këtij incidenti, që u ripërsërit edhe me shitësen e ushqimores, Poli u mbyll

brenda. Derisa Arturi i ra derës dhe e nxori me forcë nga strofulli i tij. Ndryshe nga Poli, Arturi u gëzua për të, dhe po i sillte lajme të mira.

Origjinaliteti i tregimit kishte tërhequr vëmendjen e medieve. Morin, asistentja e agjencisë, kishte përgatitur një revistë shtypi me shumë dashuri. Shumica e klientëve të tyre e kishin lexuar librin dhe kishin telefonuar për ta përgëzuar.

Një producent filmi kishte kërkuar ta takonte në zyrë dhe, Arturi kishte ruajtur ëmbëlsirën për në fund, librashitësi i “Barns & Nodëll”, ku ai ishte i rregullt, i kishte treguar se romani po shitej shumë shpejt dhe lehtë. Suksesi ishte arritur në Silikon Vallej, por me këtë ritëm, ai do të shtrihej së shpejti në të gjithë vendin, librashitësi ishte i bindur për këtë...

Në tarracën e restorantit ku mezi e kishte sjellë Polin, Arturi i vuri në dukje se ishte koha që të rruhej, të kujdesej pak më shumë për pamjen e jashtme, të merrte në telefon botuesin, i cili i kishte lënë njëzet mesazhe në zyrë, e sidomos të përqafoje këtë lumturi që po i ofronte jeta, në vend që të kishte këtë pamje të trishtuar.

Poli heshti për një moment të gjatë, mori frymë thellë dhe mendoi se një mërzi në publik do ta rëndonte rastin e tij. Një grua, që e kishte njohur, u ndërpreu drekën për ta pyetur nëse romani i tij ishte autobiografik, dhe kjo ishte goditja e fundit.

Me një ton madhështor, Poli i deklaroi Arturit se pasi kishte reflektuar shumë gjatë kësaj jave, po ia

besonte atij kabinetin e tyre. Ishte koha që të bënte një vit sabatik.

- E çfarë do të bësh? - e pyeti Arturi, i tronditur.

*Do të zhdukem*, mendoi Poli. Për ta kursyer veten nga një mësim morali, iu referua një preteksti të padiskutueshëm: Do të shkruante një roman të dytë, pra do të provonte edhe një herë. Çfarë mund të kishte Arturi kundër?

- Po qe se kjo është vërtet ajo që ti dëshiron, pse jo. Nuk e harroj se kur isha keq, shkova të jetoja disa kohë në Paris dhe ti i more përsipër të gjitha punët tona. Ku mendon të shkosh?

Poli, që nuk kishte asnjë ide, u përgjigj pa menduar:

- Në Paris. Ti m'i ke mburrur aq shumë mrekullitë e qytetit të dritave, kafenetë, urat, lagjet plot jetë dhe parisianët... kush e di, me pak shans, ajo luleshitësja magjepsëse, sharmin e së cilës ma mburrje aq shumë, ndoshta do të jetë ende atje.

- Ndoshta, - ia ktheu Arturi lakonik, - por jo çdo gjë është aq mrekulli siç e kupton ti.

- Sepse, në atë kohë, ti nuk ishe në formën tënde më të mirë. Unë kam nevojë vetëm për të ndërruar pak mjedis... për të stimuluar krijimtarinë, kupton?

- Nëse e ke për të stimuluar krijimtarinë, ok.! E kur mendon të nisësh?

- Organizojmë një mbrëmje sot në shtëpinë tënde, ftojmë Pilgezin dhe të shoqen, shoqëria do të jetë e tëra aty për lamtumirat dhe ndarjet, qysh nesër, përpara meje Franca dhe jeta e bukur!

Projekti i Polit po e trishtonte Arturin në kulm, do të kishte dashur ta kundërshtonte këtë vendim si të përshpejtuar, do të ishte më mirë për agjencinë sikur të duronte edhe disa muaj para se ta ekzekutonte planin, por ndjenja e miqësisë mori përparësinë. Po t'i ofrohej një shans i tillë atij, Poli do të bënte gjithçka për ta ndihmuar, e kishte provuar më parë këtë gjë. Sa i takon punës, do ta rregullonte si të mundte.

Pasi u përshëndet me Arturin, Poli u kthye në shtëpi tërësisht në një gjendje të tmerrshme. Nga e nxori një ide të tillë? Të qëndronte në Paris, dhe vetëm!

Duke bërë ecejake nëpër apartament, nisi të kërkonte argumente në favor të kësaj ikjeje, të çmendur dhe të pamundur. Nëse Arturi e kishte bërë, po ky pse jo? Argumenti i dytë, që zëvendësoi të parin, kishte lidhje me parisienët, i treti ishte që, më në fund, ai mund të provonte të shkruante një tjetër roman... që nuk do ta botonte... ose do ta botonte vetëm jashtë shtetit. Në mënyrë që ta kishte të mundur kthimin në San-Francisko, sapo gjërat të ishin ndrequr. Në fund fare, këto argumente bënë vetëm një: shkrimtar... amerikan... beqar... në Paris!

Dhe në Paris, ku ai jetonte prej vitesh, Poli kishte shkruar pesë romane të tjera. I lodhur nga aventurat me parisienet, ndryshimet e humorit të të cilave i dukeshin të pamundura për t'i kuptuar, ai zgjodhi beqarinë, me kusht që dhe beqaria ta zgjidhte atë.

Pesë romanet e tij nuk patën suksesin që kishte shpresuar, të paktën, jo në Europë e as në Shtetet e Bashkuara, por për një arsye që nuk e dinte, librat po korrnin sukses të jashtëzakonshëm në Azi, më saktësisht në Kore.

Prej vitesh, Poli mbante një lidhje dashurie me përkthyesen e tij koreane. Dy herë në vit, Kyongu vinte dhe e takonte, një javë, kurrë më shumë. Ishte i dhënë pas saj më shumë sesa e pranonte vetë. I vetmi problem, përballë saj, nuk e gjente dot fjalën e duhur.

Kyongu pëlqente heshtjet, Poli i urrente. Shpesh vriste mendjen sikur të kishte marrë penën për t'i fshirë, siç bëjmë me të bardhat që i mbulojmë me bojë shkrimi. Kyongu dhe ai kalonin së bashku katërmbëdhjetë ditë e gjysmë në vit, përfshi këtu dhe vajtje-ardhjet në aeroport. Kur Kyongu ishte atje, ai e shihte me orë të tëra, pa e dalluar dot nëse ishte vërtet e bukur apo vetëm për sytë e tij. Fytyra e saj ishte aq e veçantë dhe vështrimi i saj aq depërtues kur bënë dashuri, sa që ndodhte që vriste mendjen a mos po flinte me ndonjë jashtëtokësore.

Shiheshin pak, por kishin zakonet e tyre. Gjatë arratisjeve të saj parisiane, ajo donte të frekuentonte kinemanë e rrugës “Apoliner”, a thua se salla kishte më rëndësi sesa filmi që jepej, donte të përshkonte pasarelën e “Arts”, të hante një akulllore të “Bertijoni” edhe në palcë të dimrit. Donte të lexonte gazetën franceze, të bridhte nëpër librari, të shëtiste në “Mare”, të përshkonte rrugët e këmbësorëve të



lagjes “Hal” dhe të ngjiste në këmbë rrugën “Belvil”, ndërkohë që do të ishte më e thjeshtë ta zbriste atë. Donte të pinte çaj në ditët e bukura në kopshtin e muzeut të Jetës romantike, në rrugën “Shaptal”, të vizitonte koleksionin “Kamondo”, rrugën “Monso”, që Poli t’i dhuronte lule dhe të bënte me to buqeta teksa ktheheshin në shtëpinë e tij. Donte të zgjidhte djathërat te banaku i Vanosë, një mjeshtër fin, që e kishte dyqanin poshtë shtëpisë së Polit, donte që ai ta shihte dhe ta dëshironte, nuk i donte aq shumë librat e tij, por librat ishin lidhja që i kishte bashkuar.

Kyongu pushtonte gjithashtu mendjen e Polit, ndoshta edhe më shumë, kur nuk ishte aty. Përse ishte aq tërheqëse për sytë e tij, përse e merrte kaq shumë malli?

Sapo mbaronte ndonjë dorëshkrim, ajo zbarkonte tek ai. Duke e injoruar lodhjen që kaplon çdo njeri normal pas një udhëtimi prej njëmbëdhjetë orësh, ajo shkëlqente nga freskia. Pas një dreke modeste, të pandryshueshme, të përbërë nga vezë me majonezë, një fetë bukë dhe një birrë - çka në vetvete mund të ishte një ilaç i mrekullueshëm kundër ndryshimit të orarit, ide kjo që duhet t’i prezantohet ndonjë ditë shkencës, - drekë që ajo dëshironte po aq në mënyrë të pandryshueshme që ta hanin në të njëjtën kafene, në qoshe të rrugës “Brëtanjë” dhe rrugës “Sharlotë” - duhej të informoheshin mbi prejardhjen e pulave që bënin vezët e kafenesë “Lë Marshe”, në rast se ajo do të mbyllej ndonjë ditë, ata ngjiteshin në apartamentin

e Polit. Kyongu bënte dush, para se të ulej në tavolinën e punës për të lexuar. Poli ulej në këmbë të krevatit, përballë saj dhe e vëzhgonte. Humbje kohe ngaqë ajo rrinte indiferente gjatë leximit. Atëherë atij i dukej sikur vlerësimi i romanit nga ana e saj do të vendoste nëse ajo do t'i afrohej apo jo atij. Në rastin e tij, “të shkojmë më larg po të kuptohemi” i dukej se varej nga një “po, më pëlqyen kapitujt e tu”. Për këtë arsye, Poli më shumë përgjonte momentin kur ajo do t'i dorëzohej intimitetit të tyre, sesa ndonjë komenti të qartë të përkthyeses, së cilës i detyrohej për një pjesë të qenësishme të të ardhurave, duke qenë se ai jetonte me të drejtat koreane të autorit.

Ai donte të shkruante, të jetonte jashtë shtetit, i donte vizitat e Kyongut dy herë në vit dhe nëse pjesën tjetër të vitit, njëfarë vetmie nuk do të kishte qenë si shpërblim i kësaj ekzistence, atij do t'i dukej jeta e re pothuaj e përkryer.

\*

Dyert e xhamta u hapën dhe Poli i lehtësuar psherëtiu.

Arturi po shtynte një karrocë bagazhesh, ndërkohë që Lorena ia bënte me shenjë.

#### 4.

Mia hapi sytë dhe u shtriq. Iu deshën ca çaste për t’u riorientuar gjeografikisht dhe shpirtërisht. Doli nga shtrati, hapi derën e dhomës dhe kërkoi Dejin. Apartamenti ishte bosh.

Mëngjesi e priste në banakun e kuzhinës, i shoqëruar me një letër të vogël mbi një pjatë të vjetër fajance.

“Kishe nevojë për gjumë, eja tek unë në restorant kur të mundesh.”

Mia ndezi çajnikun elektrik dhe shkoi deri te dritarja. Ditën, pamja të linte pa mend. Vrau mendjen si ta kalonte mëngjesin, por edhe vazhdimin. Pa orën te sahati i furrës dhe u përpoq të imagjinonte çfarë mund të bënte Davidi, nëse ishte vetëm apo po përfitonte tërësisht nga mungesa e saj. A kishte të drejtë që i la fushë të lirë atij, duke menduar se kështu atë do ta merrte malli? Mos ia vlente më mirë të dominonte terrenin me shpresë se do ta rifitonte? Kush i mbante çelësat e kësaj enigme?

Mia nuk e dinte ç' donte, por dinte çfarë nuk donte. Dyshimin, pritjen, heshtjen. Dëshironte projekte të pamundura, por që të japin dëshirën të ngrihesh në mëngjes, të rigjesh oreksin për të jetuar dhe të mos ngrihesh më me një lëmsh në stomak.

Qielli ishte i veshur, por shi nuk binte, ishte një fillim i mirë. Nuk do të shkonte te Dejzi, parapëlqente të shëtiste në rrugët e “Montmartrit”, të kërkonte nëpër dyqane e pse jo të bënte një portret te karikaturisti i kodrës. Ishte tërësisht jashtë mode, por ishte pikërisht çka ajo kishte dëshirë. Këtu, ndryshe nga Anglia, njerëzit nuk e njihnin. Do të përfitonte nga kjo liri për të bërë çka i shkruhej në kokë.

Rrëmoi në çantën e udhëtimit, kërkoi një veshje dhe nuk mundi t'i rezistonte kureshtjes për të eksploruar apartamentin e shoqes së saj më të mirë. Vëzhgoi bibliotekën e lyer me të bardhë, raftet e të cilës ishin përkulur nën peshën e librave. Mia vodhi një cigare nga paketa e harruar mbi tavolinën e mesit, dhe po kërkonte edhe elementin më të vogël që të zbulonte identitetin e pronarit. Çfarë lloj njeriu ishte, ishte mik, apo dashnor i Dejzit, apo i dashuri ndoshta? Vetëm ideja që Dejzi e ndante jetën me dikë tjetër i ngjalli dëshirën t'i telefononte Davidit, të kthente kohën, para atij xhirimit ku një aktore e roleve të dyta ia kishte marrë atij mendjen; me sa duket nuk ishte hera e parë, por në vështrimin e saj dukej që eksperiencia kishte qenë tmerrësisht e vështirë për t'u jetuar. Mbi tarracë, ajo ndezi cigaren që po e shihte tek digjej midis gishtave.

Hyri në apartament dhe u ul në tavolinën e punës së Dejzit. Laptopi ishte i ndezur, ekrani i kyçur.

Mori telefonin dhe filloi një bisedë me mesazhe me miken e saj:

Cili është fjalëkalimi?

Kam nevojë të lexoj *e-mail*-et e mia

Nuk mund t'i lexosh në smartfonin tënd?

Jo kur jam jashtë shtetit.

Koprrace!

Ky është fjalëkalimi?

E bën me qëllim?

Çfarë?

Po punoj. Qepujkë.

?????

Është fjalëkalimi im.

Po punoj qepujkë?

Mia e la telefonin dhe shtypi fjalëkalimin. U lidh me kutinë e saj postare dhe pa vetëm një mesazh të Krestonit, i cili e pyeste ku ishte dhe përse nuk i përgjigjej në telefon. Një revistë mode i propozonte një reportazh në shtëpinë e saj, ai kishte nevojë për aprovimin e saj sa më shpejt.

Ajo shkroi:

*I dashur Kreston,*

*Jam larguar për ca kohë dhe kam besim te ti që nuk do t'i thuash asnjë njeriu, kur them asnjë njeriu, do të thotë askujt. Për të mësuar rolin që ju më detyroni të luaj, kam nevojë të jem vetëm, pa direktivat e ndonjë regjisori, ndonjë fotografi, të ndonjë prej asistenteve tuaja, apo vetë tuajat. Mosbindja është një gjë që nuk kam pasur luksin ta bëj prej dy vjetësh. Nuk do të pozoj për ndonjë revistë mode, sepse nuk kam dëshirë. Në listën e vendimeve që mora mbrëmë në bordin e "Eurostarit", e para ishte që të mos nënshtrohesha më. Kam nevojë t'i tregoj vetes se jam e aftë ta bëj këtë, të paktën disa ditë. Është kohë e bukur në Paris, do të dal të shëtis..., do t'ju jap së shpejti lajme për veten dhe do të jem e rezervuar në çdo rrethanë, rrini i qetë.*

*Gjithë të mirat!*

*Mia.*

E rilexoi dhe shtypi butonin "dërgo".

Një letër e vogël sipër në ekran i zgjoi kureshtjen, klikoi sipër. Shqeu sytë kur zbuloi faqen kryesore të një sajti takimesh.

Kishte pasur ndër mend të mos rremonte në dosjet e Dejzit, por, teksa po e risillte në mendje, nuk ishte ndonjë premtim i formuluar qartë, e pastaj Dejzi nuk do të merrte vesh asgjë.

Konsultoi profilet e burrave të seleksionuar nga mikja e saj, u shkul së qeshuri teksa lexoi disa mesazhe, shqoi dy që iu dukën interesante. Ndërkohë që një rreze dielli hyri në apartament, gjykoj se ishte koha ta linte këtë botë virtuale, që i dukej bezdisëse, për të shkuar për t'u gërricur me atë që e priste jashtë. Fiku kompjuterin, kapi një pallto të lehtë të varur në korridor.

Teksa doli nga pallati, ngjiti rrugën drejt sheshit “Tertrë”, ndali para një galerie dhe vazhdoi udhën. Një çift turistësh e panë, gruaja e tregoi me gisht dhe ajo dëgjoi t'i thoshte të shoqit: “Të siguroj që është ajo, shko e pyete!”.

Mia shpejtoi hapin dhe hyri në kafenenë e parë që i doli para. Çifti u ngul para vitrinës, Mia u ngjit pas banakut dhe porositi një shishe të vogël ujë “Vitel”, me sytë të drejtuar te pasqyra e barit ku reflektohej rruga. Priti që çifti pa takt të lodhej, pagoi dhe iku.

Me të mbërritur në sheshin “Tertrë”, vëzhgoi karikaturistët në punë e sipër, kur iu afrua një djalosh. Kishte një buzagaz dashamirës dhe një paraqitje shumë të bukur me xhinse dhe xhakëtë.

- Ju jeni Melisa Barlou, apo jo? I kam parë të gjithë filmat tuaj, - deklaroi ai në një anglishte të përsosur.

Melisa Barlou ishte emri i skenës së Mia Grinbergut.

- Po xhironi ndonjë film në Paris, apo jeni me pushime? - vijoi ai.

Mia i buzëqeshi.

- Nuk jam këtu, por në Londër. Juve ju duk sikur më patë, por s'jam unë, thjesht një grua që më ngjan.

- Ju kërkoj ndjesë, - ia ktheu ai i matur.

- Jam unë që ju kërkoj ndjesë, ajo që po them nuk ka asnjë kuptim për ju, por për mua, po. Mos më merrni inat nëse ju zhgënjeva.

- Si mund të më zhgënjejë Melisa Barlou përderisa ajo është në Angli?

Djaloshi e përshëndeti tërë respekt, bëri ca hapa dhe u kthye.

- Sikur për fatin tim më të madh të këmbeheni me të ndonjë ditë nëpër rrugët e Londrës, bota është shumë e vogël, a mund t'i thoni nga ana ime se është një aktore e jashtëzakonshme?

- Patjetër. Jam e sigurt se do t'i bëhet shumë qejfi.

Mia e pa të largohej.

- Mirupafshim, - murmuriti ajo.

Kërkoi syzet e diellit në çantë, eci pak dhe dalloj një sallon parukerie. Mendoj se Krestoni me siguri do ta bënte për ujë të ftohtë dhe vetëm kjo ide i dha akoma më shumë dëshirë që ta ekzekutonte planin e



saj. Shtyu derën, u ul në një kolltuk dhe doli një orë më vonë, brune me flokët e shkurtër.

E vendosur që të testonte marifetin e saj, u ul në shkallët e “Sakre-Kërit” dhe priti. Kur një autobus me turistë me targën e Anglisë u ndal te sheshi, Mia iu bashkua pasagjerëve që po zbrisnin, pyeti shoqëruesin për orën duke qëndruar përballë grupit që ai po shoqëronte. E bekoj parukierin që i kishte ofruar një fytyrë të re. Më në fund ishte një angleze e thjeshtë që po vizitonte Parisin, një grua anonime.

\*

Poli kishte bërë dy herë xhiro rreth bllokut të banesave, më në fund e parkoi dyshe. U kthye nga dy pasagjerët e tij, shumë i buzëqeshur.

- Atëherë, jo shumë të çorientuar?

- Me mënyrën se si e ngave ti, jo, - u përgjigj Arturi.

- Ia ke treguar atë mbrëmjen ku kalova dy orë krupull nën tavolinë e operacionit për shkak të tij? - tha ai duke iu drejtuar Lorenës.

- Njëzet herë, - ia ktheu Arturi, - pse?

- Asgjë, ja çelësat, është në katin e fundit, ngjitini valixhet, unë po parkoj makinën në parking.

Lorena dhe Arturi kishin shkuar në dhomën e tyre dhe po hapnin bagazhet.

- Sa gjynah që nuk e morët dhe Xhonë, - psherëtiu Poli teksa po hynte.

- Është udhëtim i gjatë për një fëmijë të moshës së tij, - shpjegoi Lorena, - është te kumbara dhe besoj se kjo i pëlqen shumë.

- Do të kishte qenë shumë herë më i lumtur te kumbari i tij.

- E po ne ëndërronim për pushime si dy të dashuruar, - ndërhyri Arturi.

- Ndoshta, por u bë kohë e gjatë që jeni të dashuruar, ndërkohë që unë, nuk po e shoh shpesh famullin tim.

- Kthehu të jetosh në San-Francisko, do ta shohësh përditë.

- Doni të hani diçka? Ku e futa atë kek? - murmuriti Poli duke inspektuar dollapët e kuzhinës. - Jam i sigurt që bleva një kek.

Lorena dhe Arturi shkëmbyen një vështrim.

U shërbeu kafe dhe u tregoi programin që kishte hartuar.

Meqë kishte dalë dielli, dita e parë do t'i kushtohej vizitës së vendeve kult parisiane, kullës “Eifel”, “Harkut të Triumfit”, ishullit të qytetit, “Sakre-Kërit” dhe po të mos u dilte koha, do të vazhdonin të nesërmen.

- Si dy të dashuruar..., - kujtoi Arturi.

- Sigurisht, - ia ktheu Poli, pak i bezdisur.

Lorena kishte nevojë të çlodhej para se të ndërmerrnin një maratonë të tillë. Të dy

bashkëpunëtorët duhet të kishin plot gjëra për t'i treguar njëri-tjetrit dhe ajo i ftoi të hanin pa të.

Poli propozoi ta shpinte Arturin në një kafene disa hapa larg shtëpisë. Në mesditë tarraca ishte plot diell.

Arturi veshi një këmishë të pastër dhe e ndoqi nga pas.

Të ulur në tavolinë, të dy miqtë po vëzhgonin njëri-tjetrin pa thënë asgjë. A thua se secili po ruante kush do të fliste i pari.

- A je i lumtur këtu? - u dorëzua Arturi.

- Po, domethënë, besoj se po.

- Beson?

- Po kush mund të jetë i sigurt që është i lumtur?

- Ka shumë gjasa të jetë një fjali shkrintari, por këtu jam unë që po ta bëj pyetjen.

- Si do ti që të të përgjigjem?

- Të vërtetën.

- E dua zanatin tim, ndonëse kam gjithmonë ndjesinë e të qenët ndonjëherë uzurpator, kam shkruar vetëm gjashtë romane, ti e di. Me sa duket shumë shkrintarë e ndiejnë këtë, të paktën kështu më kanë rrëfyer disa kolegë.

- Takon shumë të tillë?

- Jam regjistruar në një klub shkrimi jo larg prej këtu, shkoj një mbrëmje në javë, dërdëllisim, flasim për momentet kur bllokohemi, e pastaj shkojmë dhe e mbyllim mbrëmjen në ndonjë birrari. Është lezetshëm, por teksa po dëgjoj veten duke ta treguar, duket si diçka e mërzitshme.

- Nuk jam kundër.

- Po ti, si je? Kabineti po lulëzon?

- Po flisnim për ty.

- Unë shkruaj, kjo është e vetmja punë në të vërtetë.

Marr pjesë në ndonjë sallon libri. Ndonjëherë, bëj autografe në librari. Vitin e kaluar shkova në Gjermani dhe në Itali ku librat shiten pak. Shkoj në një palestër dy herë në javë, e kam tmerr këtë, por me ato që ha, është e domosdoshme, dhe pastaj shkruaj, por unë po përsëris atë që thashë, apo jo?

- Kjo duket si shumë e gëzueshme, - fishkëlleu Arturi me ton ironik.

- Nuk besoj, unë jam i lumtur natën. Takohem me personazhet e mia, dhe atëherë po, jeta bëhet e gëzueshme.

- Ke ndonjë?

- Edhe po, edhe jo. Ajo nuk është shpesh këtu, që të them të vërtetën nuk është kurrë, por unë mendoj për të pa pushim, ti e ke idenë e kësaj situate, apo jo?

- Kush është?

- Përkthyesja ime koreane, u çudite, apo jo? - thirri Poli, gjoja i gëzuar. - Po pra, me sa duket jam bërë popullor në Kore. Nuk kam shkelur asnjëherë atje, ti e di sa tmerr i kam avionët, ende nuk e kam marrë veten nga avioni që më solli këtu.

- Po kjo ka ndodhur para shtatë vjetësh!

- Sikur ka qenë dje, njëmbëdhjetë orë turbulenca. Një kalvar i vërtetë.

- Megjithatë një ditë do të të duhet të nisesh.

- Nuk është i sigurt, unë mora leje qëndrimin. Ose me anije, pastaj.

- Po ajo përkthyesja?

- Është një grua e jashtëzakonshme, megjithëse nuk e njoh shumë, në fakt. Po lidhem gjithmonë e më shumë nga viti në vit. Marrëdhënia jonë në distancë nuk është e lehtë.

- Ti më dukesh shumë i vetmuar, Pol.

- A nuk ishte ti që më deklarove një ditë se vetmia është një formë shoqërie? E mirë, boll folëm për mua! Po ju? Më trego ca foto të Xhosë, duhet të jetë rritur tashmë.

Një grua shumë e bukur u ul në tavolinën pranë së tyres. Poli nuk i kushtoi vëmendje, çka e shqetësoi Arturin.

- Mos më shih ashtu, - e mori fjalën Poli, - aventura kam pasur më shumë sesa e imagjinon ti, e pastaj është Kyongu. Me të, është ndryshe, kam përshtypjen se jam vetvetja, se nuk luaj më rol, nuk ndihem i detyruar të josh. Ajo ka mësuar të më njohë nëpërmjet librave të mi, çka është kulmi, megjithëse unë besoj se ajo nuk i pëlqen.

- Askush nuk e detyron të të përkthejë.

- Ajo shton ndoshta nga pak për të më tërbuar, ose për të më shtyrë përpara.

- Por ndërkohë ti jetuake vetëm!

- Ti do të mendosh se unë kaloj kohën duke të parafrazuar, por kush e ka thënë: mund të duam dikë e të jemi prapëseprapë vetëm.

- Situata ime ishte pak e veçantë, je dakord?
- Edhe imja.
- Ti që shkruan, duhet të përpiloje listën e gjërave që të bëjnë të lumtur.
- Po unë jam i lumtur, e marrtë dreqi!
- Dukesh.
- E marrtë dreqi, Artur, mos fillo të më analizosh, e kam tmerr, pastaj ti s' di asgjë nga jeta ime.
- Ne njihemi qysh në adoleshencë, nuk kam nevojë për shpjegim teksti për ta gjetur se si je. A e mban mend çfarë thoshte ime më?
- Ajo thoshte shumë gjëra. Meqë ra fjala, do të doja të përdorja shtëpinë në Karmel si dekor të romanit tim të ardhshëm. U bë një kohë e gjatë që s'kam shkuar atje.
- Kush e ka fajin?
- Për çfarë më ka marrë malli tmerrësisht, - e rimori fjalën Poli, - janë rendjet pas çokollatave "Girardeli", shëtitjet deri te maja e kalasë, mbrëmjet, zënkat në zyrë, mënyra se si bënim planet për të ardhmen, në të gjitha bisedat që nuk na shpinin asgjëkund... ne të dy.
- U takova me Onegën.
- Të foli për mua?
- Po, i tregova që jetoje në Paris.
- Vazhdonte e martuar?
- Nuk kishte unazë.
- S' duhej të më kishte lënë. Ti e di, - shtoi Poli duke buzëqeshur, - ajo ishte xhelozë për miqësinë tonë.

\*

Mia vëzhgoi karikaturistin e sheshit “Tertrë” dhe iu duk simpatik, madje më mirë bukurosh, ai që kishte një palë pantallona pëlhere, një këmishë të bardhë dhe një xhaketë skoceze. U rehatua te karrigia palosëse përballë tij dhe i kërkoi të ishte sa më besnik të mundej.

- “E vetmja dashuri besnike është sedra”, thoshte Gitri, - tha karikaturisti me zërin e ngjirur.

- Kishte shumë të drejtë.

- Fatkeq në dashuri?

- Përse ma bëni këtë pyetje?

- Sepse jeni vetëm dhe sapo dolët nga parukieri. Shpesh thuhet “prerje e re flokësh, jetë e re”.

Mia e fiksoi e çuditur.

- Gjithmonë shpreheni me citime?

- U bënë njëzet vjet që vizatoj portrete, kam mësuar të lexoj jo pak gjëra në një shikim. Juaji është i bukur, interesant, megjithatë, ta çelnit pak nuk do të bënit keq. Boll folëm, nëse doni që lapsi im t’i jetë besnik modelit, mos lëvizni.

Mia u drejtua.

- Me pushime në Paris? - vazhdoi karikaturisti duke mprehur karbonin.

- Edhe po, edhe jo, po kaloj disa ditë te një mikeshë, ka një restorant në lagje.

- Duhet ta njoh, “Monmartre” është sa një fshat.

- “La Klamada”.

- Ah, mikesha juaj qenka ajo provansalja e vogël! Është vajzë guximtare. Kuzhina e saj është krijuese dhe jo e shtrenjtë. Ndryshe nga të tjerët, ajo nuk u qepet turistëve. Shkoj herë pas here të drekoj atje, është vajzë me karakter.

Mia vëzhgoi duart e karikaturistit dhe i ra në sy unaza.

- Keni dëshiruar ndonjëherë ndonjë grua tjetër përveç suajës?

- Ndoshta, për një kohë sa hap e mbyll sytë, ose për sa kohë më është dashur për të ditur deri në ç'pikë e doja timen.

- Nuk jeni së bashku?

- Po, jemi.

- Atëherë përse përdorët të pakryerën.

- Mos flisni, jam duke ju pikturuar buzët.

Mia e la artistin të bënte detyrën. Seanca zgjati pak më shumë sesa e kishte imagjinuar. Kur burri mbaroi punën, e ftoi të shkonte të shihte rezultatin te këmbaleci i tij.

- Me të vërtetë ngjaj me këtë unë?

- Sot, po, - tha karikaturisti. - Shpresoj që së shpejti të buzëqeshni si në këtë vizatim.

Nxori telefonin nga xhepi, i bëri asaj një foto dhe e krahasoi me vizatimin.

- Me të vërtetë që ia dolët mbanë, - e përgëzoi Mia.

- A mund të bëni një portret duke u nisur nga një foto si kjo këtu?

- Besoj po, po të jetë e pastër.



- Do t'ju sjell një të Dejzit, jam e sigurt se do të lumturohej po të kishte një të sajën, ju paskeni penel të mirë.

Karikaturisti u përkul për të rrëmuar në një nga dosjet me piktura, të mbështetura te këmbaleci. Tërhoqi një fletë dhe ia zgjati Mias.

- Është shumë e bukur mikja juaj e restorantit, - tha ai. - Kalon çdo mëngjes para meje. Po jua dhuroj.

Mia vështroi fytyrën e Dejzit. Nuk ishte karikaturë, por një portret i vërtetë, që riprodhonte shprehjen e saj me shkathtësi dhe sensibilitet.

- Po ju lë timen në këmbim, - tha ajo, para se të përshëndeste karikaturistin.

\*

Poli bëri që pritja të mos ishte barrë për ta. Me një guxim që vetëm ai është i aftë, u fut para në radhën që zgjatej në këmbë të kullës “Eifel”, duke fituar kësisoj një orë të mirë nga programi. Në katin e fundit, pati marrje mendsh dhe u kap pas parmakut duke mbajtur mjaft distancë nga parvazi. I la Arturin dhe Lorenën të admironin pamjen pa të, duke iu betuar se e njihte përmendësh Parisin. Pas zbritjes me ashensor me sytë e mbyllur, rigjeti dinjitetin dhe i shpuri miqtë në kopshtin e “Tyilërive”.

Lorena, teksa pa fëmijët të rrotulloheshin në karusel, ndjeu nevojën urgjente t'i telefononte Natalisë për të dëgjuar zërin e të birit. Ftoi Arturin që

të afrohej te stoli ku ishte ulur. Poli përfitoi nga rasti për të blerë ca ëmbëlsira. Lorena e vëzhgoi nga larg ndërkohë që Arturi po diskutonte me Xhoin.

Pa ia ndarë sytë, ajo mori telefonin, e mbyti të birin me fjalë dashurie, i premtoi se do t'i sillte një dhuratë nga Parisi dhe pothuaj u zhgënjye kur konstatoi se atë nuk e kishte marrë dhe aq shumë malli për të. Ai zbavitej shumë te ndrikulla.

E mbuloi me puthje dhe e mbajti aparatën ngjitur te veshi, ndërkohë që Poli po kthehej, duke u stërmunduar duke mbajtur tre pambuk sheqeri në një dorë.

- Si t'u duk? - pëshpëriti ajo.
- Mua më flet, apo Xhoit? - pyeti Arturi.
- Xhoi e mbylli.
- Atëherë përse bën gjoja sikur po flet në telefon?
- Me qëllim që Poli të rrijë pak larg.
- Mirë, m'u duk se ishte i lumtur, - u përgjigj Arturi.
- Ti nuk di të gënjesh.
- Nuk është kritikë, shpresoj.
- Vetëm një konstatim. E vure re që llogotiste pa pushim?
- Është shumë i vetmuar dhe nuk do ta pranojë.
- Nuk ka asnjë në jetën e tij?
- Unë jetova katër vjet në Paris duke qenë beqar.
- Por ti ishe i dashuruar me mua. Nuk ke pasur ndonjë histori të vogël me ndonjë luleshitëse? - pyeti Lorena.

- Edhe ai është i dashuruar. Ajo jeton në Kore. Ai madje mendon të qëndrojë me të. Librat e tij atje kanë sukses të jashtëzakonshëm.

- Në Kore?

- Po, paçka se mendoj se nuk është e vërtetë dhe projekti i tij më duket absurd.

- Pse, ai e do me të vërtetë atë grua?

- Kam përshtypjen se ajo nuk e do aq sa e do ky. Ai ka shumë frikë nga avioni, dhe po të niset, rrezik nuk kthehet më kurrë. E imagjinon ti të jetojë vetëm në Kore? Edhe kështu dhe Parisi është mjaft larg San-Franciskos.

- Ti nuk ke të drejtë ta pengosh, nëse ai e dëshiron vërtet këtë.

- Kam të drejtën që ta provoj ta bind.

- Për të njëjtin Pol po flasim?

Poli që duroi shumë, erdhi drejt tyre me një hap të vendosur.

- A mund t'i flas famullit tim?

- Sapo e mbylli, - ia ktheu Lorena, konfuze.

E sistemoi celularin dhe i drejtoi atij një buzëqeshje të madhe.

- Çfarë po komplotonit, ju të dy?

- Absolutisht asgjë, - u përgjigj Arturi.

- Mos u shqetësoni, nuk do t'ju ngjitem nga pas gjatë kohës së qëndrimit tuaj këtu. Kam dëshirë të përfitoj nga ju, por do t'ju lë shumë shpejt të qetë.

- Po edhe ne kemi dëshirë të përfitojmë prej teje, përndryshe, pse do të kishim ardhur në Paris.

Poli mbeti mendueshëm, fjalët e Lorenës kishin kuptim.

- Me të vërtetë mendova se po komplotonit. Për çfarë po flisnit atëherë?

- Për një restorant ku do të doja t'ju shpija sonte të dyve, atje shkoja shpesh kur jetoja në Paris. Me kusht që të na lësh të shkojmë të çlodhemi, nuk mund të bëjmë dot më turistin, - pohoi Arturi.

Poli e pranoi ftesën. Të tre miqtë morën rrugicën e “Kastiliones” deri në rrugën “Rivoli”.

- Ka një stacion taksish jo larg prej këtej, - tha Poli duke ecur në rrugën këmbësore.

Semafori u bë jeshil dhe Arturi e Lorena nuk patën kohë ta ndiqnin.

Vala e madhe e qarkullimit i ndau. Një autobus kaloi para tyre. Lorena vuri re tabelën reklamuese në faqen anësore:

*Mund të takoni gruan e jetës në këtë autobus, me përjashtim të rastit kur ajo merr metronë...*

... njoftonte një sajt takimesh në Internet.

Lorena e gjuajti me bërryl Arturin dhe ata ndoqën me sy autobusin, para se të shikonin njëri-tjetrin.

- Ashtu po mendon dhe ti? - pëshpëriti Arturi.

- Druaj se na dëgjon në anën tjetër të bulevardit.

- Ai kurrë nuk do të regjistrohej në një sajt të tillë.

- Kush tha që ta bënte ai? - tha ajo duke u tallur.

- Kur fati ka nevojë për një gisht ndihmë, miqësia e kërkon që të zgjasësh një dorë... Kjo s'të kujton ndonjë gjë?

\*

Mia vuri syzet e diellit me skelet gualli, të blera te një antikuar gjatë pasdites. Me ato xhamat e trasha, nuk shihte mirë. Shtyu derën e restorantit.

Që nga salla plot e përplot, nga një dritare e madhe e hapur në mur, klientët që ishin të ulur në tavolina mund ta shihnin Dejzin duke punuar në kuzhinë. Kuzhinieri dukej sikur nuk dinte ku të përplaste kokën. Dejzi kapi disa pjata dhe u zhduk. U hap një derë dhe ajo u rishfaq, duke shkuar drejt një tavoline me katër veta. U shërbeu dhe iku shpejt duke cikur Mian pa e pasur mendjen. Fill para se të hynte në kuzhinë, u zbyth tre hapa.

- Më vjen keq, - njoftoi ajo, - nuk ka më vende.

Mia, syzet e të cilës e bënë të shihte vëngër, ngulmoi.

- As edhe një vend të vogël fare? Mund të pres, - tha ajo duke ndryshuar zërin.

Dejzi u rrotulla qejfprishur në fytyrë.

- Njerëzit atje po kërkojnë llogarinë, po aq llafazanë sa janë ata... Vetëm jeni? Nëse ju pëlqen një vend te banaku, - i sugjeroi ajo duke i dëftuar qoshen e barit.

Mia pranoi dhe shkoi të ulej mbi një stol.

Priti disa minuta derisa erdhi Dejzi, kaloi pas banakut, i shtroi tryezën dhe u kthye për të marrë një gotë të varur në një raft. I zgjati menynë dhe e njoftoi se nuk kishin më midhje "Saint-Jacques". Restoranti

shërbente vetëm prodhime të freskëta, ishin shitur të gjitha.

- Sa gjynah, unë kam ardhur enkas nga Londra për midhjet tuaja “Saint-Jacques”.

Dejzi e këqyri me vëmendje, dyshuese, para se të kërcente përpjetë.

- Uauuuu! - shpërtheu ajo. - Fatmirësisht që nuk i kisha duart plot, do t'i kisha lënë të gjitha. Sa e çmendur je!

- Nuk më njohe?

- Nuk të pashë me të vërtetë, por ç'të ka sjellë këtu?

- Nuk të pëlqen?

- Nuk kam kohë, kamerierja më la shyt, nuk ishte mbrëmja për këtë gjë. Po të kesh uri, po të përgatis diçka, përndryshe...

- Ke nevojë për ndihmë?

- Melisa Barlou, kameriere, po më?

- Unë shoh vetëm Mian këtu, e fol me zë të ulët!

Dejzi e pa nga koka te këmbët.

- A do të dije ta mbaje një pjatë pa e rrëzuar?

- Kam luajtur një rol kameriereje dhe ti e di sensin tim të perfeksionit, jam trajnuar mirë.

Dejzi ngurroi. Dëgjoji zilkën së cilës i binte ndihmëskuzhinieri, klientët nguteshin, ai kishte nevojë për përforsime.

- Hiqi këta gjyzlykë qesharakë dhe më ndiq!

Mia e shoqëroi deri në kuzhinë. Dejzi i dha një përparëse dhe i tregoi gjashtë pjatat që prisnin nën llambat për ngrohje.

- Kjo është për 8-ën.

- 8-ën? - pyeti Mia.

Në të djathtë të hyrjes, tavolina me atë tipin që flet fort, ji e dashur me të, është klient i rregullt.

- Klient i rregullt, - përsëriti Mia duke kapur pjatat.

- Jo më shumë se katër njëherazi për xhiron tënde të parë në sallë, të lutem.

- Si urdhëron, - iu përgjigj Mia duke kapur pjatat.

E përmbushi detyrën dhe u kthye menjëherë të kërkonte ç'kishte mbetur tjetër për të shërbyer.

E çliruar nga shërbimi, Dejzi i ridha kuzhinës ritmin që i përshtatej. Sapo përgatitjet përfundonin, binte zilka dhe Mia shpejtonte. Kur nuk shërbente, pastronte tryezat, mblidhte llogaritë dhe vinte të merrte instruksione nën vështrimin e zbavitur të Dejzit.

Rreth orës 23:00, restoranti filloi të zbrazej.

- Një euro e gjysmë bakshish, këtë më la “klienti yt i rregullt”.

- Unë nuk thashë që ishte bujar!

- Dhe më shihte duke pritur që ta falënderoja.

- Gjë që ti e bëre, shpresoj?

- E po më, pastaj?

- Dua të di kur të erdhi në mendje kjo ide e çuditshme që të ndryshoje pamje?

- Sapo mora vesh që kishe nevojë për një zëvendëse. Pse, s'të pëlqen?

- Nuk je më ti, duhet të mësohem me këtë ndryshim.

- Prej kohësh nuk i sheh filmat e mi, por kam pasur pamje më të këqija se kjo.

- Punoj shumë e nuk shkoj dot në kinema, mos m'u mërzit. A mund të shërbesh këto ëmbëlsirat? Sa do të doja ta mbyllja e të shkoja të shtrihesha.

Mia e luajti në mënyrë të përkryer rolin deri në fund të mbrëmjes, duke fituar vlerësimin e një mikeje që e merrte për të paaftë për të bërë një trimëri të tillë.

Në mesnatë, klientët e fundit lanë restorantin. Dejzi dhe kuzhinieri rregulluan kuzhinën, ndërsa Mia po vinte rregull në sallë.

Sapo ulën qepenat, u nisën në këmbë përmes rrugëve të "Monmartrit".

- Kështu ndodh çdo mbrëmje? - pyeti Mia.

- Gjashtë ditë në javë. Është rraskapitëse, por nuk do ta ndërroja zanatin tim me asnjë tjetër. Kam shans, jam në shtëpinë time, ndonëse fundmuajt janë të tmerrshëm.

- Ishte dëng sonte.

- Ishte një mbrëmje e mirë.

- Çfarë bën të dielave?

- Fle.

- Po jeta sentimentale?

- Ku do që ta vë jetën sentimentale, midis dhomës frigoriferike dhe kuzhinës?

- Nuk ke takuar askënd që kur ke hapur restorantin?

- Kam njohur disa burra, por asnjëri nuk i rezistoi orareve të mia. Jeta ndahet me dikë që ushtron të njëjtin zanat me ty. Sa burra do t'i toleronin mungesat e tua kur nisesh në xhirime?



- Nuk ndaj më kushedi çfarë.
- Hapat e tyre kumbonin nëpër rrugët e shkreta.
- Ndoshta do të katandisemi vajza plaka të dyja, -  
tha Dejzi.
- Ti ndoshta, jo unë.
- Maskarëshë!
- Sa do të doja!
- Kush të pengon?
- Po ty, kush të pengon? Zaten, ku i ke takuar ata burra? Klientë ishin?
- Unë nuk e përziej kurrë dashurinë me punën, -  
u përgjigj Dejzi. - Vetëm një herë. Ai vinte shumë  
shpesh, tepër shpesh, atëherë arrita të kuptoja  
menjëherë se nuk vinte aty vetëm për kuzhinën.
- Si ishte? - pyeti Mia, e intriguar.
- Jo keq, aspak keq madje.
- Mbërritën poshtë pallatit, Dejzi formoi kodin dhe  
ndezi dritën para se të ngjisnin shkallët.
- Si jo keq?
- Kishte sharmë.
- Po më?
- Çfarë do të dish më?
- Gjithçka. Si të joshi, natën e parë me të, sa zgjati  
historia juaj dhe si përfundoi?
- Po të duash, presim të vemi në katin e fundit.
- Duke hyrë në apartament, Dejzi u lëshua në kanape.
- Jam e sflitur, do të na përgatisësh një çaj? Me sa  
duket është e vetmja gjë që dinë të bëjnë anglezët në  
kuzhinë.

Mia i tregoi gishtin e mesit dhe kaloi pas banakut. E mbushi çajnikun dhe priti që Dejzi të mbante premtimin.

- Ishte një mbrëmje fillimkorriku, vitin e kaluar. Restoranti ishte pothuaj bosh, isha duke fikur furrat kur ai hyri. Ngurrova, e pastaj ç'të të them, detyra profesionale më detyroi. I dhashë leje kuzhinierit dhe kamerieres. Me një klient, mund të çalltisja edhe e vetme. I paraqita menynë, ai më kapi dorën dhe më tha të zgjidhja ç'të doja, më ishte mirënjohës që ndenja vetëm për të. Dhe mua, si një budallaqe, kjo gjë m'u duk shumë e këndshme.

- Pse si një budallaqe?

- U ula përballë tij ndërkohë që ai darkonte, madje dhe çupita diçka me të. Ishte i këndshëm, plot gjallëri. Donte të më ndihmonte në ngritjen e tryezës, kjo më argëtonte, e lashë ta bënte. Kur mbyllëm restorantin, më propozoi të pinim një gotë. Thashë po. Ecëm deri te tarraca e një kafeneje. Aty ribëmë botën dhe ishte një botë e bukur. Ai ishte i pasionuar pas kuzhinës dhe nuk gënjente. Pse mos ta pohoj që besova në mrekulli. Më përcolli deri poshtë shtëpisë, nuk u orvat të ngjitej, shkëmbyem vetëm një puthje. Kisha takuar njeriun e përkryer. Nuk ndaheshim më, ai vinte çdo fundmbrëmje, më ndihmonte ta mbyllja, i kaloja të dielat tek ai, në fakt, deri në fund të verës, pastaj, më tha se nuk mund të vazhdonte dot më.

- Pse?

- Sepse e shoqja dhe fëmijët ishin kthyer nga pushimet. Do të të jem shumë mirënjohëse po të mos bësh asnjë koment. Tani do të bëj një dush dhe do të fle, - përfundoi Dejzi para se të mbyllte derën e dhomës.

\*

Duke dalë nga restoranti “L’Ami Lui”, Lorena u ndal për të admiruar fasadat e vjetra të rrugës “Verbua”.

- Po i dorëzohesh magjepsjeve të Parisit? - pyeti Poli.

- Të vaktit të mrekullueshëm që sapo përpimë, pa asnjë dyshim, - tha ajo.

Një taksi i çoi në shtëpi. Sapo mbërriti, Poli përshëndeti miqtë dhe u mbyll në zyrë për të shkruar.

Lorena u rehatua në krevat dhe filloi të shkruante në kompjuterin e saj “Mac”. Arturi doli dhjetë minuta më vonë nga banja dhe u fut në çarçafë.

- Po ti në këtë orë i lexon *e-mail*-et? - u habit ai.

Ajo vuri kompjuterin mbi gjunjë dhe ndërsa Arturi po zbulonte, i shtangur, çka ajo po ndërmernte, u shkri së qeshuri.

Ai u detyrua të lexonte rreshtat e parë të tekstit të shkruar nga Lorena:

*Romancier, beqar, epikurian që punon shpesh mbrëmjeve, që e do humorin, jetën dhe rastësinë...*

- Besoj se ke pirë shumë verë sonte.

Dhe duke mbyllur ekranin, ai shtypi pa dashje butonin që afishonte regjistrimin e Polit në sajtin e takimeve.

- Nuk do të na i falte kurrë që i punuam një rreng të tillë.

- Atëherë, duhet t'i kërkosh ndjesë sa më shpejt, pasi kam frikë se ajo zhurma e vogël që dëgjuam...

Arturi hapi me të shpejtë kompjuterin, i dërrmuar nga proçka e tij.

- Mos u bëj kështu, vetëm ne kemi mundësi hyrjeje në atë llogari dhe ideja që t'ia trazonim pak përditshmërinë nuk është se s'më pëlqen.

- Nuk dua të riskoj me të, - ia ktheu Arturi.

- Mos do të të kujtoj çfarë ka riskuar ai për ne? - iu përgjigj ajo duke fikur dritën.

Arturi mbeti një çast të gjatë me sytë e shqyer në terr. I erdhën në memorie një mijë e një kujtime të arratisjeve të çmendura dhe të shejtanllëqeve. Poli desh rrezikoi dhe burgun për të. Arturi ia detyronte lumturinë e sotme guximit që tregoi miku i tij.

Parisi i kujtonte orë të trishta, vite të vetmisë së madhe. Ishte tani radha e Polit ta jetonte dhe Arturi e dinte sa mund të rëndonte kjo vetmi. Por kishte dhe mënyra të tjera për ta nxjerrë nga kjo situatë përveçse nëpërmjet një sajti takimesh.

- Fli, - i murmuriti Lorena, - do të shohim, mbase do të ndodhë ndonjë gjë interesante.

Arturi u kruspullosoi pas së shoqes dhe e zuri gjumi.

\*

Ajo u rrotullua njëqind herë në krevat pa e zënë gjumi, bloi në mendje këto javët e fundit pa gjetur as gëzimin më të vogël. Dita që rrodhi nuk kishte qenë më e mira që kishte kaluar prej shumë kohësh, paçka se mungesa e tjetrit nuk e kishte lënë rehat.

U rivesh, dhe doli nga apartamenti pa zhurmë.

Jashtë, një shi i imët kishte lagur kalldrëmin e rrugëve të zeza. Ngjiti kodrën deri te sheshi “Tertrë”. Karikaturisti po rregullonte këmbalecin. Ngriti kokën për ta parë teksa ajo po ulej në një stol.

- Shqetësim nate? - pyeti ai duke u ulur pranë Mias.

- Pagjumësi, - ia ktheu ajo.

- E di. Unë nuk arrij dot të mbyll sy para orës 2:00 të mëngjesit.

- Po gruaja, ju pret çdo mbrëmje?

- Shpresoj se është duke më pritur, - u përgjigj ai me zërin e tij të çjerrë.

- Nuk të kuptoj.

- Ia dhatë mikeshës portretin?

- Akoma nuk ka ardhur rasti, do t'ia jap nesër.

- A mund të të kërkoj një favor? Mos i thoni që ia kam bërë unë. Më pëlqen të drekoj tek ajo dhe nuk e di përse, por do të isha në siklet po ta merrte vesh.

- Përse?

- Sepse është ndërhyrje në punët e tjetrit po të vizatosh fytyrën e dikujt pa ta kërkuar ai.

- Po ju gjithsesi e kenë pikturuar.

- Më pëlqen tek e shoh të kalojë në mëngjes përpara këmbalecit, atëherë pata dëshirën ta kapja këtë fytyrë që më sjell gjendje të mirë shpirtërore.

- A mund ta vë pak kokën në supin tënd, pa keqkuptimin më të vogël?

- Ejani, supi im është i shurdhët.

Së bashku e në heshtje, ata soditën hënën e sapomjegulluar në qiellin e Parisit.

Në orën 2:00 të mëngjesit, karikaturisti u kollit.

- Nuk po flija, - tha Mia.

- As unë.

Mia u ngrit.

- Ndoshta është koha të themi mirupafshim, - sugjeroi ajo.

- Natën e mirë, - tha karikaturisti duke u çuar.

U ndanë në sheshin “Tertre”.